



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1024/6 Prot.

Tiranë, më 04.07.2018

V E N D I M

Nr. 22 datë 04.07.2018

**MBI MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR APLIKIM,  
KONKURIM, REGJISTRIMIT TË FITUESVE, TARIFAVE TË SHKOLLIMIT  
PËR TË DY CIKLET E STUDIMEVE,  
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS .**


Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH", neni 3, pika 3 /ç, neni 6, pika 27,28,30, neni 38, neni 83, neni 85 , në VKM nr. 288 datë 21.05.2018" Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në IPAL, në një program të ciklit të parë të studimeve ose në një program të integruar të studimeve profesionale me kohë të plotë", Udhëzimit nr.18 datë 21.05.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë në IAL, për vitin akademik 2018-2019", në Vendimin e Rektoratit nr.111 datë 22.06.2018, Vendimin e Senatit Nr.27 datë 28.06.2018, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 04.07.2018,

V E N D O S I:

1. Të miratojë tarifën e regjistrimit në konkurimin praktik të aplikantëve , tarifa e aplikimit të kandidatëve dhe tarifa e regjistrimit të fituesve për të dy ciklet e studimit për vitin akademik 2018-2019, sipas tabelave bashkangjitur .
2. Të miratojë tarifën e shkollimit për ciklin e parë të studimeve bachelor për vitin akademik 2018-2019, sipas tabelës bashkangjitur
3. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së Institucionit të Arsimit të Lartë Publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.

4. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së Institucionit të Arsimit të Lartë Publik si përsëritës në një lëndë apo në shumë lëndë dhe vijon studimet në vitin pasardhës, i nënshtrohet tarifës së shkollimit për kredit për detyrimet apo lëndët përsëritëse, si dhe tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
5. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi të ciklit të parë në një program tjetër studimi të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin transferohen dhe ndjekin studimet.
6. Kandidatët/aplikantët, që kanë përfunduar me sukses një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, sipas kritereve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi dhe, në këtë rast, aplikantët fitues përballojnë koston e plotë të studimeve, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.
7. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në një program të parë apo në një program të dytë studimi të ciklit të parë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë vjetore të shkollimit, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në këto programe studimi në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave vjetore të shkollimit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dërgon për çdo vit listën e studentëve të huaj që përfitojnë nga marrëveshjet zyrtare shtetërore.
8. Të miratojë tarifën e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2018-2019, sipas tabelës bashkangjitur.
9. Studentët të cilët nuk kanë përfunduar programin përkatës të studimit të ciklit të dytë apo nuk kanë shlyer të gjithë provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohëzgjatjen normale të tij dhe konsiderohen mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë çdo vit akademik tarifën për kredit të parashikuar sipas këtij vendimi.
10. Studentët e ciklit të dytë të studimeve e paguajnë tarifën e shkollimit të ndarë në këste.
11. Tarifat e aplikimit, regjistrimit në konkurs, të regjistrimit të fituesve dhe tarifat vjetore të shkollimit, të bëhen publike në faqen zyrtare të Universitetit [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).
12. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerezore dhe Arkivës, Drejtoria e marrëdhënieve me jashtë, Projekteve dhe TI, Dega e informacionit Studentor dhe regjistrimeve.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

  
Vladimir Gjollës



**Tab 1**

**Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes**

Tarifa e regjistrimit në konkurset e pranimit praktik (në Ciklin e parë të studimeve, program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve )	5000lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Ciklin e parë të studimeve, program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2000lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve)	2500lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve )	3000lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (trasferim studimesh në programe të ciklit e dytë të studimeve )	3000lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2000lekë

Emërtimi i Programit cikli i parë Bachelor	Tarifa për program të parë studimi ( në lekë) për vitin akademik 2018-2019	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2018-2019
Shkencat e Lëvizjes	35000	233916

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Profesional	Tarifa për kredit për program të parë studimi ( në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2018-2019	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2018-2019
Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetsor në Arsimin Parauniversitar	1240 (148 800)	1270 (152 400)

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Shkencor	Tarifa për kredit për program të parë studimi ( në lekë)/ 120 kredite(në lekë) për vitin akademik 2018-2019	Tarifa për kredit për program të dytë studimi ( në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2018-2019
Shkenca Sportive (FSHL)	2250 (270000)	2625 (315 000)

Tarifa e regjistrimit në konkurset e pranimit praktik (në Ciklin e parë të studimeve, program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve )	5000lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Ciklin e parë të studimeve, program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2000lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve)	2500lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve )	3000lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (trasferim studimesh në programe të ciklit e dytë të studimeve )	3000lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2000lekë

Emërtimi i Programit cikli i parë Bachelor	Tarifa për program të parë studimi ( në lekë)për vitin akademik 2018-2019	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2018-2019
Fushat e veprimtarisë fizike të shëndetit dhe të rekreacionit	35000	233916

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Profesional	Tarifa për kredit për program të parë studimi ( në lekë)/ 60 kredite (në lekë) për vitin akademik 2018-2019	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 60 kredite (në lekë) për vitin akademik 2018-2019
Menaxhim në Sport dhe Turizëm	1250 (75 000)	1520 (91 200)
Aktivitet Fizik dhe Rekreacion-Trainer fitness (FVFR)	1330 (79 800)	1530 (91 800)

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Shkencor	Tarifa për kredit për program të parë studimi ( në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2018-2019	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2018-2019
Aktivitet Fizik dhe Shëndeti (FVFR)	2250 (270 000)	2625 (315 000)